

# La Rubrica Legal

La rubrica in cui i professionisti di freebly approfondiscono e commentano la loro materia



**MALBORA GJOKA**

[malbora.gjoka@freebly.com](mailto:malbora.gjoka@freebly.com)

## COMPLIANCE & MANAGEMENT PJESA I

### SHOQERITE TREGTARE DHE VANTAZHET E MENAXHIMIT TE RREGULAVE

Nje shoqeri tregtare e çfaredo lloj natyre qofte ajo eshte nje subjekt juridik i detyruar te respektoj nje ser rregullash qe mund te kene prejardhje nga burime te ndryshme. Keto rregulla mund te kene prejardhje nga ligji i nje shteti ose nga marreveshjet internacionale te neshkruara nga qeveria. Kjo kategoria rregullash eshte e detyrueshme per to (Mandatory Compliance Word), cfare nen kupton qe subjektin tregtare nuk ka zgjidhje tjeter veç ti respektoj ato per te evituar aplikimin e sanksione te ndryshme qe shteti parashikon per mos respektimin e tyre.

Veç rregullave te detyrueshme shoqeria tregtar aplikon brenda struktures se saj dhe rregulla te ashtu quajtura vullnetare. (Voluntary Compliance Word). Keto norma/rregulla, nuk jane te imponuara nga shteti por jane rezultat i nje zgjedhje te bere nga vete shoqeria tregtare. Aplikimi i ketyre normave sjell nje ser vantazhesh ne lidhje me imazhin, kapacitetin e prodhimit, menaxhimin e personelit, furnizuesve e klienteve te cilat reflektojne direkt ne fitimet e ndermarrjes dhe jetegjatsine e saj.

Mund te themi qe shoqeria tregtare eshte nje lloj "sistemi djellor" i vogel ku ne qender ndodhet struktura dhe rreth saj orbitojne normat e detyrueshme dhe vullnetare, interesat dhe aspetativat e subjekteve te ndryshem qe kane maredhenie direkte apo indirekte me ndermarrjen. (stakeholder).

Ligji i Ashby-t (1902-1972) - formuluar rreth 50 vjet me pare nga nje mendimtar angles- thote qe: "Per te kontrolluar nje sistem, duhet te kemi ne dispozicione nje sistem menaxhimi/kontrolli te pakten te te njejtit nivel kompleksi ose te nje niveli me te larte se ate qe duhet kontrollua". Me pak fjale, drejtuesit e nje shoqerie tregtare duhet te kene ne dispozicion nje kompleks rregulla sjelljesh qe duhet te balancojne nevojat e menaxhimit te struktures dhe gjithe varjanteve te saj.

Ky ligj na meson qe, n.q.s nje subjekt tregtar deshiron te perballoj me sukses te papriturat e ardhshme, te struktures se tij te brendshme dhe te tregut, duhet te jet ne gjendje te krijoj nje numer te mjaftueshem ideshe, opinionesh, pikpamjesh, zgjidhjesh e mundesish alternative per te mare vendimin e duhur; coerent jo vetem me momentin historik ne te cilin behet fjale por dhe me kapacitetet teknike ne dispozicion te shoqerise.

Kujdes, kjo nuk do te thote qe shoqeria tregtare duhet te ndertoj nje sistem menaxhimi te komplikuar dhe te veshtire per ta kuptuar. Shpesh eshte nevojshme parashikimi i pak rregullave, ne pikat kyçe te ndermarrjes, per te bere te mundur funksionimin eficient te saj dhe kapacitetit per te perballuar te papriturat e tregut.

Vazhdon... " Normat ISO: Internazionali Standart Organization"